



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës /  
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science*

Kabineti i Ministririt / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Nr. 01-263

Dt. 04.06.2026

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nënparagrafit 1.5 të paragrafit 1 të nenit 11 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (G. z. e Republikës së Kosovës/nr. 34/18 nëntor 2022, Prishtinë si dhe Udhëzimit administrativ nr. 20/2023 për krijimin e skemave për mbështetje financiare të studentëve për ndarjen e bursave, nxjerr:

#### V E N D I M

**Për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentet vajza/gra të regjistruara për herë të parë në fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës - STEM në Universitetet Publike të Republikës së Kosovës**

1. Lejohet shpallja e konkursit për ndarjen e bursave për vitin akademik 2025-2026 për studentet vajza/gra të regjistruara për herë të parë në fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës - STEM në Universitetet Publike të Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Departamenti i arsimit të lartë të shpall konkursin për ndarjen e bursave për vitin akademik 2025-2026 për studentet vajza/gra të regjistruara për herë të parë në fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës - STEM në Universitetet Publike të Republikës së Kosovës.
3. Shuma e bursës është **1.000.00 euro** (njëmijë euro) për vit akademik për studente.
4. Të drejtë aplikimi kanë studentet që janë të regjistruara për herë të parë në programet e studimit STEM të vitit akademik 2025/2026.
5. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Ar sy et im

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë dhe kërkesën e DALSH në MASH me nr. ref.5-942 te dt. 13.05.2026 për lejimin e shpalljes për ndarjen e bursave për vitin akademik 2025-2026, u vendos si ne dispozitiv të këtij vendimi.

### Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministrit/MASH;
2. Zyrës së SP/MASH;
3. DALSH/MASH;
4. Arkivit/MASH.

Hajrulla Çeku

Ministër në detyrë/MASH

